



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:134334
Datë: 29.01.2024
Numri i dokumentit: 05252053

C.nr.185/2017

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtarin Baki Shigjeqi, dhe bashkëpunëtoren profesionale B.G. duke vendosur në çështjen juridiko- kontestimore të paditësve M.D.N. me numër personal dhe B.D.N. me numër personal që të dy me vendbanim në fshatin komuna e Suharekës, të cilët me autorizim i përfaqëson av.Q.H. nga Suhareka, kundër të paditurit I.N. me numër personal me vendbanim në fshatin komuna e Suharekës, të cilin me autorizim e përfaqëson av.S.H. nga Suhareka, për shkak të liritimit nga sendet dhe dorëzimit të paluajtshmërisë në posedim, vlera e kontestit 3,100.00 euro, pas seancën së shqyrtimit kryesor të mbajtur në prezencë të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datë 17.01.2024, ndërsa me datë 29.01.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësve M.D.N. dhe B.D.N. që të dy nga fshati Gjinoc, komuna e Suharekës, përmes të cilës kanë kërkuar që të **“Aprovohet në tërësi e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësve M. dhe B.n. dhe të Detyrohet i padituri që ta lirojë nga sendet dhe t’ia dorëzojë në posedim të lirë, ngastrën kadastrale P-72116020-.... në sipërfaqe prej 119 m² ZK Gjinoc, vendi i quajtur BLLATA/OGRAKHA, tok bujqësore arë e klasës së 5, e cila kufizohet nga ana veriore e saj me parcelën 00451-0 me gjatësi prej 35.27m, nga ana lindore kufizohet me parcelën 00450-1 me gjatësi prej 6.85m, ndërsa nga ana jugore kufizohet me parcelën 00450-1 me gjatësi 34.75m, nga ana veriore është e rrethuar me mur prej bllokave të betonit, ndërsa nga ana lindore gjendet e ndërtuar një depo P+0 e cila nga ana perëndimore është e hapur, në afat prej 15 ditësh, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë, Detyrohet i padituri që ti bart shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1,975.20 euro”, si tërësisht e PABAZUAR.**

- II. **DETYROHEN** paditësit M.D.N. dhe B.D.N. që në emër të shpenzimeve procedurale t’ia paguajnë të paditurit I.N. shumën prej 1,216.80 euro, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit M.D.N. dhe B.D.N. që të dy nga fshati komuna e Suharekës, të cilët me autorizim i përfaqëson av.Q.H. nga Suhareka, me dt. 02.05.2017, pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padi, të cilën e kanë precizuar në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, ndaj të paditurit I.N. nga fshati komuna e Suharekës, të cilin me autorizim e përfaqëson av.S.H. nga Suhareka, me objekt të padisë lirimi nga sendet dhe dorëzimi i paluajtshmërisë në posedim, vlera e kontestit 3.100 euro.

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre me parashtresën e datës 01.11.2023, kanë bërë precizimin e padisë në aspektin subjektiv duke e zgjeruar kështu edhe ndaj një të paditurit tjetër krahas këtij ekzistues dhe atë ndaj E.N., për të cilën kërkesë gjykata me Aktvendimin C.nr.185/2017 të datës 06.12.2023, e ka lejuar propozimin e paditësve edhe për një të paditur tjetër dhe e ka ftuar E.N. nga fshati komuna e Suharekës që në afat prej 7 ditësh të deklarohe lidhur me kërkesën e paditësve. Me parashtresën e datës 20.12.2023, E.N. ka deklaruar se e kundërshton në tërësi aktvendimin e kësaj gjykate me të cilin është lejuar që të zgjerohet padia në aspektin subjektiv në cilësi të palës së paditur të jetë edhe E.N. ashtuqë nuk ka dhënë pëlqimin që në këtë fazë të procedurës të futet si e paditur krahas të paditurit ekzistues.

Gjykata me aktvendimin procedural të datës 17.01.2024, ka refuzuar propozimin e të autorizuarit të paditësve për zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv që krahas të paditurit I.N. në këtë çështje kontestimore në cilësi të palës së paditur të futet edhe E.N.

1.Pretendimet e palëve ndërgjyqëse.

Paditësit në padinë e parashtruar më datë 02.05.2017 dhe gjatë seancave gjyqësore ka theksuar se babai i paditësve D.H.N. në bazë të aktgjykimit të kësaj gjykate C.nr.88/07 i dt.16.03.2009 është vëretuar se është pronar i pjesës së ngastrës kadastrale 450 në sipërfaqe prej 119m² ZK Gjinoc, i cili aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.141/2009 I dt.25.10.2009. Pas vdekjes së babit të tyre paditësit kanë zhvilluar procedurën e trashëgimisë dhe janë shpallur trashëgimtar në tërë pasurinë e trashëgimisë së trashëgimlënësit sipas aktvendimit LRP.nr.4699/2016 të datës 11.08.2016. Për shkak të të metave që aktgjykimi ka pasur-nuk ka pasur titull ekzekutiv se çka do të ekzekutohet dhe për shkak se i padituri nuk ka pranuar në mënyrë vullnetare ta dorëzoi paluajtshmërinë e lartcekur në posedim të lirë të paditësve, paditësit janë detyruar që të ndjekin këtë rrugë ligjore për të kërkuar dorëzimin e paluajtshmërisë nga njerëzit dhe sendet në posedim dhe pronësi të paditësve. Sa i përket pretendimeve të palës së paditur se e njëjta nuk ka legjitimitetin pasiv të palës në procedurë, nuk qëndron pasiqë këto pretendime i ka pasur edhe në procedurën paraprake në të cilën është vendosur në mënyrë meritore ndaj paditësve dhe paraardhësve të paditëse iu është njohur e drejta e pronësisë në ngastrën e cila është objekt kontesti. Po ashtu se pala e paditur kërkon legjitimitet vërtetohet edhe nga fakti se e njëjta në procedurën administrative e ka pasur rolin aktiv, duke bërë kërkesë për rishqyrtimin e vendimit ZKK në

Suharekë me nr.594832022 të datës 08.06.2022, me të cilin vendim është aprovuar kërkesa e palëve paditëse për ekzekutimin e aktgjykimit C.nr.88/2007 i datës 16.03.2009. Andaj, po të mos kishte legjitimitet pasiv siç pretendon pala paditur nuk do ta merrte rolin aktiv në procedurë administrative. Ndërkaq me parashtresën e datës 01.11.2023 dhe në seancën e datës 17.01.2024, ka kërkuar zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv ndaj edhe një të padituri tjetër E.N. për faktin se pas daljes në teren me datë 15.05.2023, me ekspert gjedoet, E.N. personalisht ka theksuar se është poseduese e kësaj prone. Paditësi nuk ka mundur të dijë një fakt të tillë pasi që prona objekt kontesti rrjedhë sipas aktgjykimit të po kësaj gjykate C.nr.88/07 e në të cilin aktgjykim këtu i padituri ka qenë vetë i paditur. Po ashtu raportet familjare mes dy palëve në procedurë janë raporte armiqësore, nuk kanë kontakt, nuk flasin, andaj edhe i njëjti nuk ka pasur sit ë dijë deri në kohën e daljes në teren nga kjo gjykatë se këtë pronë kush e posedon, andaj bazuar në nenin 258 par.4 ka kërkuar nga gjykata që të aprovojë propozimin për zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv dhe si palë e paditur të jetë edhe E.N.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësve ka deklaruar se pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor dhe nga provat e administruara, pa dyshim është vërtetuar se kërkesëpadia e paditësve ka mbështetje ligjore dhe si e tillë duhet aprovuar. Nuk ishte kontestuese as legjitimiteti i palës së paditur pasi që i padituri I.N. ka qenë palë e paditur edhe në procedurën e zhvilluar kontestimore C.nr.88/07, si dhe i padituri edhe në procedurën administrative ka bërë ankesë ndaj aktvendimit të ZKK-së në Suharekë, me të cilin aktvendim është regjistruar, ekzekutuar Aktgjykimi C.nr.88/07 i datës 16.03.2009. Andaj, i padituri në të gjitha procedurat tjera kur kemi të bëjmë me ngastrën kadastrale 0450-2 ZK Gjinoc, paska legjitimitet dhe nuk e konteston legjitimitetin, përkundrazi merr rol aktiv në procedurë, por vetëm në këtë procedurë kontestimore konteston legjitimitetin. Pala e paditur e ka orientuar edhe kumatën e tij E.N. që në seancën e terrenit të deklaron se është poseduese e pronës që është objekt i këtij kontesti. I ka propozuar gjykatës që të aprovoje në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, duke detyruar të paditurin që ta lirojë nga sendet dhe t'ia dorëzoj në posedim të lirë ngastrën kadastrale 0450-2 në sipërfaqe prej 119m² ZK Gjinoc. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për 9 seanca të mbajtura nga 202.80 €, gjithsej shumën 1,825.20€, për pagesën e ekspertit të gjeodezisë shumën 150€, pra në shumën totale prej 1,975.20€.

I padituri I.N. përmes të autorizuarit të tij av.S.H. në seancat e shqyrtimit përgatitor dhe kryesor ka deklaruar se, e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e parashtruar si të pabazuar. Padinë e ka kundërshtuar në aspektin formal-juridik dhe material-juridik. Në aspektin formal-juridik për faktin se i padituri I.N. nuk mund të ketë legjitimitet në këtë çështje për të qenë palë në procedurë pasi që prona që është objekt kontesti nuk evidentohet në emër të tij e as që i njëjti është shfrytëzues i kësaj pjese të pronës që paditësi pretendon që njëjta ti dorëzohet. Nga certifikata mbi të drejtën e pronës së paluajtshme nr.952-2/2017-5054 e dt.25.10.2017, rezulton se parcela nr.450 në vendin e quajtur “Bllata” me sipërfaqe prej 968m² evidentohet në emër të H.N. tani i ndjeri gjyshi i të paditurit. I padituri është vetëm një nga trashëgimtarët e gjyshit të tij në të cilin është evidentuar kjo parcelë kontestuese. Në skicën e terrenit e dt.04.06.2004 e hartuar nga gjeodet I.G. dhe M.K. është shkruar se shfrytëzues i kësaj parcele është S.R.N. Ndërsa lidhur me kërkesën e palës paditëse për zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv ndaj edhe të një padituri tjetër të njëjtën e ka kundërshtuar, për faktin se për fajin e paditësit nuk

është bërë me kohë zgjerimi i kërkesëpadisë pasiqë që nga deklaratimet e para në vitin 2017, pala e paditur ka potencuar faktin se i padituri I.N. nuk ka legjitimitet për të qenë palë në këtë procedurë, fakt i cili është vërtetuar edhe me rastin e daljes në teren. Sipas nenit 264.2, momenti i fundit të bashkimit të një pale në procedurë (paditës apo paditur), është përcaktuar të jetë momenti deri në përfundimin e seancës përgatitore, përkatësisht seancës për shqyrtim kryesor të çështjes poqëse seanca përgatitore nuk është caktuar fare. Ka shtuar se, regjistrimi i paraardhësit të paditësve i pronar i ngastrës kontestuese është bërë në mënyrë të kundërligjshme, duke pasur parasysh faktin se aktgjykimi C.nr.88/07 i datës 16.03.2009 në dispozitivin e këtij aktgjykimi nuk është i përshkruar numri i njësisë kadastrale dhe për këtë nuk ka pasur elaborate të hartuar nga eksperti gjeodezisë, mirëpo në ZKK të Suharekës kemi pasur ndërhyrje në skicën e terrenit nga personat jo kompetent ku i është dhënë numër i veçantë kësaj parcele 450-2 dhe është bërë bartja në emër të paraardhësit të paditësve.

Në fjalën përfundimtare, i autorizuari i të paditurit deklaroi se mbetet në tërësi pranë të cekurave në seancat e mbajtura, duke e kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në aspektin formal-juridik për faktin se pala e paditur nuk ka legjitimitet për të qenë palë në këtë procedurë. Paditësit, bazën juridike të kërkesëpadisë e ka mbështet në aktgjykimin C.nr.88/07 dt.25.10.2017 lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren-dega Suharekë, ku palë e paditur gabimisht ka qenë I.N. ngase prona e cila ka qenë objekt kontesti ka qenë e evidentuar në emër të gjyshit të tij tani të ndjerë. Nga gjendja faktike rezulton se në këtë pronë pushtetin faktik e ka ushtruar S.N. në mënyrë të pandërprerë i cili ka vdekur, ndërsa pas vdekjes së tij pushtetin faktik e ushtron gruaja e tij dhe fëmijët. Bazuar në provat e administruara i ka propozuar gjykatës që ta refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar e cila ka të bëjë me dorëzimin e parcelës me nr.450-2 me sipërfaqe prej 119m² dhe ti detyroje paditësit që ti paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë për përgjigje në padi 156€, për mbajtjen e 10 seancave nga 200€, shumën prej 2000€, 4 të pa mbajtura 100x4=400, gjithsej shumën prej 2556€, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

2.Gjendja faktike e vërtetuar

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimeve kryesore-publik të datës 27.12.2017, 07.03.2022, 26.04.2023 dhe 17.01.2024, sipas propozimit të palëve ka administruar provat relevante dhe atë: aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Suharekë C.nr.88/07 të datës 16.03.2009; aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.141/2009, të datës 25.10.2011; aktvendimi i noterit M.J. LRP.nr.4699/2016, Ref.T.nr.980/216, të datës 10.08.2016; certifikatën pronësore me numër të lëndës 952-2/20117-5054 të datës 25.10.2017, të lëshuar nga ZKK në Suharekë; aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren-dega në Suharekë CP.nr.634/14 i datës 06.10.2015; aktvendimin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës nr.03/2328/19 i datës 07.11.2019; aktvedimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.4317/15 i datës 08.03.2017; aktvendimin e Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Suharekë me nr.11-463-63578-2019 i datës 17.09.2019; aktvendimin e Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Suharekë nr.673/2018 i datës 16.09.2019; konkluzionin e Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër me nr.673/2018 i datës 02.09.2019; kërkesën e datës 06.08.2019 të të autorizuarit të paditurit

av.S.H. aktvendimin e Zyres Komonale Kadastrale në Suharekë datë 952-2/2019-59483 i datës 02.09.2019; ekspertizën e gjeodezisë të gjeodetit D.B. nga Prizreni dhe shiqimi i skicës së terrenit e datës 14.07.2022; dëgjimi i ekspertit gjeodet D.B. plotësimin e ekspertizës së gjeodezisë të gjeodetit D.B. e datës 16.10.2023 dhe skicën e terrenit; çertifikatën e pronësisë për njësinë kadastrale P-00450-2 dhe kopjen e planit, lëshuar me datë 15.06.2022 nga zyra kadastrale e komunës së Suharekës; skica e terrenit e datës 04.06.2004, e përpiluar nga gjeodeti M.K. dhe aktvendimin me numër 594832022 lëshuar nga zyra komunale kadastrale në Suharekë me datë 08.06.2022.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është **e pa bazuar**.

Nga aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Suharekë C.nr.88/07 të datës 16.03.2009, gjykata ka vërtetuar faktin se D.H.N. (paraardhësi i paditësve) i është vërtetuar e drejta e pronësisë në ngastrën kadastrale 451-0 sipas fletëposedimit nr.86 ZK Gjinoc si dhe pjesës së ngastrës kadastrale 450 në sipërfaqe prej 0.01,19 ha në gjatësi prej 7m kah lindja në mezhdën e numrit 226 shkon deri në mezhdën nr.161 në drejtim të perëndimit në një gjatësi prej 35,5m, duke e detyruar të paditurin në atë procedurë civile (i paditur edhe në këtë kontest) I.N. që ta pranojë që e njëjta të regjistrohet në librat e tokës si pronë e paditësit (D.N.).

Nga aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.141/2009, të datës 25.10.2011, gjykata ka vërtetuar faktin se është refuzuar ankesa e të paditurit si e pa bazuar dhe është vërtetuar aktgjykimi i lartëpërmendur me të cilin D.N. i është vërtetuar e drejta e pronësisë mbi ngastrën kadastrale të specifikuar si më lartë.

Nga aktvendimi i noterit M.J. LRP.nr.4699/2016, Ref.T.nr.980/216, të datës 10.08.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se është zhvilluar procedura për ndarjen e trashëgimisë së D.N. (paraardhësi i këtu paditësve) në të cilën procedurë janë shpallur trashëgimtar M.N. dhe B.N. me ½ (një me dy) e të gjithë masës trashëgimore.

Nga çertifikata pronësore me numër të lëndës 952-2/20117-5054 të datës 25.10.2017, të lëshuar nga ZKK në Suharekë, gjykata ka vërtetuar faktin se njësia kadastrale P-72116020-..... në sipërfaqe prej 968m², në vendin e quajtur “Billata Orgaxha” është i evidentuar si posedues H.(R) N.

Nga aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren-dega në Suharekë CP.nr.634/14 i datës 06.10.2015, gjykata ka vërtetuar faktin se është pezulluar procedura përmbartimore për përmbartimin e aktgjykimit të plotfuqishëm C.nr.88/07 të datës 16.03.2009, e inicuar nga kreditorët M.N., R.B., B.N., K.V., S.A. dhe F.B. kundër debitorit I.N.

Nga aktvendimi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës nr.03/2328/19 i datës 07.11.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se është refuzuar ankesa me nr.03/2328/19 e dt.14.10.2019, e parashtruar

nga M.N. kundër aktvendimit me nr.673/2018 të dt.16.09.2019, të lëshuar nga Drejtoria për Shërbimin Pronësoro-Juridike, Gjeodezi dhe Kadastër KK Suharekë si e pa bazuar, dhe është vërtetuar ky aktvendim.

Nga aktvendimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr.4317/15 i datës 08.03.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se është refuzuar e pabazuar ankesa e kreditorëve dhe është vërtetuar Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren-dega në Suharekë CP.nr.634/2014 i datës 06.10.2015.

Nga aktvendimi i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Suharekë me nr.11-463-63578-2019 i datës 17.09.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se është aprovuar kërkesa e I.N. (këtu i paditur) dhe është anuluar-shfuqizuar aktvendimi nr.952-2/2019-59483 i datës 20.09.2019, ashtuqë parcela kadastrale 00450-0 në sipërfaqe prej 968 m² ZK Gjinoc, është kthyer në gjendjen e mëparshme para ndarjes.

Nga aktvendimi i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Suharekë nr.673/2018 i datës 16.09.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se është refuzuar kërkesa e M. dhe B.N. (këtu të paditur) për regjistrimin e pjesës kadastrale nr.450-0 në sipërfaqe prej 119m² ZK Gjinoc, sipas aktgjykimit C.nr.88/07 i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm, për shkak se sipas evidencës që ekziston në ZKK Suharekë parcela kadastrale nr.450-0 evidentohet në sipërfaqe prej 968m² ZK Gjinoc.

Nga konkluzioni i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër me nr.673/2018 i datës 02.09.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se është pezulluar përkohësisht vendosja në çështjen administrative për bartjen e paluajtshmërisë sipas aktgjykimit C.nr.88/07 të dt.16.03.2019, e inicuar nga M. dhe B.N. (këtu paditësit) për shkak të dorëzimit të provave plotësuese-dokumenteve për vërtetimin e bazës juridike.

Nga kërkesa e datës 06.08.2019 të të autorizuarit të paditurit av.S.H. gjykata ka vërtetuar faktin se I.N. (këtu i paditur) ka parashtruar kërkesë për rishqyrtimin e aktvendimit pranë Zyrës Kadastrale Komunale në Suharekë, me të cilin është aprovuar kërkesa e këtu paditësve për ndarjen e njësisë kadastrale 00450-0 në sipërfaqe prej 119 m² në bazë të aktgjykimit C.nr.88/07 I dt.16.03.20009, pasi që ky aktgjykim nuk është i përmbarueshëm për shkak të të metave që ka.

Nga aktvendimi i Zyres Komunale Kadastrale në Suharekë datë 952-2/2019-59483 i datës 02.09.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se është aprovuar kërkesa e M.N. (këtu paditës) për ndarjen e njësisë kadastrale 00450-0 në sipërfaqe prej 968m², duke e krijuar gjendjen e re të kësaj njësie kadastrale me ndarje në parcelën kadastrale 00450-1 në sipërfaqe prej 849m², në parcelën kadastrale 00450-2 në sipërfaqe prej 119m² ZK Gjinoc, të cilat edhe mëtej mbesin në emër të H. (R) N.

Nga ekspertiza e gjeodezisë të gjeodetit D.B. nga Prizreni dhe shiqimi i skicës së terrenit e datës 14.07.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se parcela 00450-2 e cila është objekt i këtij kontesti, gjendet në ZK Gjinoc, aktualisht shfrytëzohet si kopshtë i gjelbëruar, nga ana veriore e saj është e rrethuar me mur prej bllokave të betonit, ndërsa nga ana lindore gjëndet e ndërtuar një

depo P+0 e cila nga ana perëndimore është e hapur. Sa i përket gjendjes zyrtare, sipas certifikatës së pronës datë 15.06.2022, parcela 00450-2 në sipërfaqe prej 119m² është e evidentuar në emër të pronarit D. (H) N. Gjykata ka bërë dëgjimin e ekspertit gjeodet në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 26.04.2023, në të cilën i njejtë ka deklaruar se mbetet në tërësi në të thënat në eskpertzën e datës 14.07.2022, duke ju përgjigjur pyetjeve të palëve ndërgjygjëse ka shtuar se, në shiqimin zyrtar grafik në gjeoportalin shtetëror është konstatuar se parcela nr.450-0 nuk ekziston në atë sistem, e njëjta ka pësuar ndryshime dhe është ndarë në dy pjesë në sipërfaqe të ndryshme. Sa i përket shfrytëzimit të ngastrës objekt kontesti, eksperti gjeodet ka shtuar se bazuar në aktvendimin e gjykatës nuk ka qenë detyrë e tij që të konstatoj shfrytëzuesin e kësaj parcele.

Nga plotësimi i ekspertizës së gjeodezisë të gjeodetit D.B. e datës 16.10.2023 dhe skicën e terrenit, gjykata ka vërtetuar faktin se sipas gjendjes zyrtare, parcela nr.0450-2 kufiohet nga ana veriore me parcelën nr.00451-0, nga ana lindore me parcelat nr.00455-2, ndërsa nga ana jugore me parcelën nr.00450-1, e njëjta ka këto dimensione, nga ana veriore 35.27m, nga ana lindore 6.85m ndërsa nga ana jugore 34.75m.

Nga certifikatën e pronësisë për njësinë kadastrale P-00450-2 dhe kopjen e planit, lëshuar me datë 15.06.2022 nga zyra kadastrale e komunës së Suharekës, gjykata ka vërtetuar faktin se njësia kadastrale 00450-2 në sipërfaqe prej 119m², është e evidentuar në emër të D. (H) N. si posedues. Ndërkaq me kopjen e planit janë të përcaktuara kordinatat e kësaj ngastre kadastrale.

Nga skica e terrenit e datës 04.06.2004, e përpiluar nga gjeodeti M.K. gjykata ka vërtetuar faktin se ngastrën kadastrale me numër 450, e ka pasur në shfrytëzim S.R.N.

Nga aktvendimi me numër 594832022 lëshuar nga zyra komunale kadastrale në Suharekë me datë 08.06.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se është aprovuar kërkesa e parashtruar nga M.N. (këtu paditës), e cila ka të bëjë me bartjen e posedimit-në bazë të pranimit, sipas Aktgjykimit C.nr.88/07 dt.16.03.2009, ashtuqë ngastra kadastrale 00450-2 të bartet në emër të D. (H) N.

3.Baza ligjore

Neni 93 i Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDS), ka përcaktuar se, “*Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi*”, me nenin 103 të po të njejtit ligj përcaktohet, “*Personi i cili e ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë*”, me nenin 106 të po të njejtit ligj është përcaktuar, “*Me vdekjen e poseduesit, posedimi kalon tek trashëgimtari*”, gjykata vlerëson se bazuar në këto dispozita ligjore paditësit kanë të drejtë të kërkojnë kthimin në posedim të ngastrës kadastrale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket refuzimit të kërkesës për zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv në anën e palës së paditur, gjykata është mbështetur në nenin 258.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili ka përcaktuar “*Paditësi mund ta ndryshojë padinë më së voni deri në përfundimin e seancës përgatitore apo deri në fillimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, po që se seanca përgatitore nuk është caktuar fare*”, neni 260.1 i po të njejtit ligj ka përcaktuar, “*Po që se*

plotësohen konditat e përcaktuara në nenin 258 paditësi mund ta ndryshojë padinë edhe ashtu që në vend të të paditurit të parë ta padisë një person tjetër”, ndërsa pika 2 “Për ndryshimin e padisë në mënyrën e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni është i nevojshëm pëlqimi i personit që duhet të hyjë në gjykim në vend të të paditurit, e po që se i padituri ka filluar të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore, nevojitet edhe pëlqimi i tij”.

4.Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Nga provat e administruara, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike, nuk del të jetë kontestues fakti se paditësit janë shpallur trashëgimtarët e të ndjerit D.N. me ½ të masës trashëgimore të tij, dhe se ngastra kadastrale kontestuese është e evidentuar në emër të trashëgimlënësit të tyre D.N. Ndërsa, kontestuese ishte çështja nëse i padituri I.N. është apo jo në shfrytëzim të kësaj ngastre kontestuese pra a ka legjitimitet real pasiv në këtë çështje juridiko-kontestimore, dhe nëse duhet të largohet nga ngastra kontestuese dhe të njëjtën t’ia lënë në posedim dhe shfrytëzim të lirë paditësve.

Nga të lartëcekurat gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit M.N. dhe B.N. janë trashëgimtar të trashëgimlënësit D.N. dhe bazuar në aktvendimin LRP.nr.4699/2016, Ref.T.nr.980/2016, të njëjtit janë shpallur trashëgimtar të të gjithë masës trashëgimore, dhe bazuar në të njëjtën sa i përket pretendimeve të palës së paditur në raport me legjitimitetin real aktiv të palës paditëse në procedurë gjykata i ka vlerësuar si të pa bazuara. Po ashtu bazuar edhe në nenin 106 të LPDTS-së, i cili ka përcaktuar se me vdekjen e poseduesit në këtë rast D.N. posedimi kalon tek trashëgimtarët e tij, këtu paditësit.

Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve të pabazuar, për faktin se pas administrimit të provav të dorëzuara nga vet palët ndërgjyqjësë si dhe pas daljes në vend me ekspert gjeodet, konform dispozitave të nenit 326 të LPK-së, nga vrojtimi i drejtëpërdrejt, gjykata ka vërtetuar se i padituri I.N. nuk është në posedim/shfrytëzim të kësaj paluajtshmërie, objekt kontesti. Në seancën e terrenit të datës 15.06.2022 dhe atë të datës 16.05.2023, në të cilën ishin prezent palët ndërgjyqjësë, të autorizuarit e tyre dhe eksperti gjeodet, gjykata ka konstatuar se pas konsultimeve me anëtarët e familjes, u vërtetua se në këtë shtëpi jetojnë personat E.N. dhe R.N. të cilët janë kunata e të të paditurit dhe djali i vëllaut të tij. Në pyetjen e parashtruar nga gjykata se e kujt është shtëpia e ndërtuar në parcelën 450-1 dhe nga kush shfrytëzohet 450-2, paditësit kanë deklaruar se shtëpia është dhe shfrytëzohet nga S.N. dhe familjarët e tij. Sipas vlerësimit të gjykatës padia mund të paraqitet vetëm ndaj personit i cili pretendohet se është duke i shkelur të drejtat subjektive civile të paditësit e në këtë rast posedimin e lirë të sendit të tij (paluajtshmërisë). Çdo person që mban sendin e huaj është i legjitimuar realisht si i paditur në procesin kontestimor të vënë në veprim me anë të padisë për dorëzimin e sendit, e që në rastin konkret i padituri nuk ka qenë posedues i sendit. Gjykata i’a fali besimin edhe skicës së terrenit të datës 04.06.2004, sipas të cilës janë të evidentuar disa ngastra kadastrale dhe shfrytëzuesit e atyre ngastrave, njëra ndër to është edhe ngastra kadastrale 450 objekt kontesti, në të cilën si shfrytëzues është S.R.N. vëllai i këtu të paditurit.

Pala paditëse nuk i ka ofruar asnjë provë gjykatës përmes të cilës do të vërtetohej se i padituri është në shfrytëzim të kësaj paluajtshmërie, përkundër kësaj në seancën e këqyrjes në vend të mbajtur me datë 16.05.2023, vet kanë deklaruar se shtëpia e ndërtuar në parcelën 450-1 dhe parcela 450-2, shfrytëzohet nga S.N. dhe familjarët e tij. Ndërsa sa i përket pretendimeve të palës paditëse se i padituri I.N. ka qenë në të gjitha procedurat në lidhje me këtë paluajtshmëri i paditur, gjykata i ka vlerësuar si jo relevante për faktin se kjo procedurë është zhvilluar sipas padisë për lirim nga sendet dhe dorëzimin e paluajtshmërisë, nuk ka të bëjë fare me asnjë procedurë tjetër dhe bazuar në nenin 103 të LPDT-së, ku është rregulluar posedimi, i njëjti ka përcaktuar se personi i cili ushtron pushtetin faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë, e që në rastin konkret i padituri nuk ka ushtruar pushtetin faktik mbi sendin-paluajtshmërinë objekt kontesti, andaj edhe nuk ka legjitimitet real pasiv.

Sa i përket kërkesës së palës paditëse të dhënë pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes, për zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv ndaj edhe të një padituri tjetër konkretisht E.N. gjykata e ka refuzuar konform nenit 260.2 të LPK-së, pasi që personi E.N. nuk ka dhënë pëlqimin për të qenë palë e paditur në këtë çështje juridike kontestimore në këtë fazë të procedurës. Sipas dispozitës së nenit 258 dhe 260 të LPK-së, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes juridike, paditësi mund ta ndryshojë padinë e vet duke e paditur personin tjetër në vend të të paditurit të parë ose krahas tij, nëse zhvillimi i procesit kontestimor sjell në pyetje saktësinë e legjitimitetit pasiv të palës së paditur më parë. Mirëpo personi që do të hyjë në proces, përkatësisht në gjykim, duhet të jap pëlqimin, ndërsa nëse i padituri ka filluar të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore, nevojitet edhe pëlqimi i tij. E që në rastin konkret personi E.N. me parashtresën e datës 20.12.2023, nuk ka dhënë pëlqimin e saj për të marrë pjesë në këtë procedurë kontestimore.

Ndaj aktvendimit me të cilin gjykata ka lejuar propozimin e paditësve për zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv dhe ka ftuar personin e tretë E.N. që të deklarohej lidhur me kërkesën e paditësve që e njëjta të i bashkangjitet procesit në cilësi të të paditurës në këtë procedurë, gjykata ka bërë një lëshim teknik sa i përket këshillës juridike për faktin se i ka udhëzuar palët e pakënaqura se kundër këtij aktvendim mund të paraqesin ankesë, kjo duke mos respektuar nenin 258.6 të LPK-së, ndërsa anë seancën e datës 17.01.2024, parashtruesi i ankesës e ka tërhequr ankesën, andaj edhe shqyrtimi ka vazhduar me procedurën e provave dhe fjalën përfundimtare të palëve.

Sa i përket pretendimeve të palës së paditur se bartja e pronësisë nga H. (R) N. e kaluar në emër të D.N. në regjistrat kadastral është bërë në mënyrë të kundërligjshme, gjykata nuk i mori parasysh për faktin se nuk ishte objekt i kontestit mënyra e bartjes së pronësisë nga një person në personin tjetër, dhe se në rast të dyshimeve eventuale në raport me këtë bartje të njëjtit mund të zhvillojnë procedura të tjera pranë organeve kompetente.

Gjykata ka bërë vlerësimin edhe të provave të tjera të administruara dhe të përmendura më lartë, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në zgjidhjen meritore të kësaj çështje juridike.

Numri i lëndës: 2019:134334
Datë: 29.01.2024
Numri i dokumentit: 05252053

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori bazuar në nenin 452.1, lidhur me nenin 463, të LPK-së dhe TA-së, ku e obligoi palën paditëse të paditurit në emër të shpenzimeve procedurale ti paguajë shumën e përgjithshme prej 1,216.80 € dhe atë: për përfaqësimin në 9 seanca të mbajtura nga 135.20€ (9x135.20=1,216.80€). Gjykata ka refuzuar kompensimin e shpenzimeve në emër të përgjigjes në padi për faktin se i padituri nuk ka paraqitur përgjigje në padi, si dhe për 2 (dy) seancë gjyqësore për faktin se nuk janë mbajtur, andaj edhe nuk ia ka njohur këto shpenzime. Po ashtu lartësia e shumës së kërkuar për përfaqësim në seancë nga pala e paditur është 200€, ndërsa bazuar në Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, gjykata ka vërtetuar se përfaqësimi në kontestet civile në kontestet deri në 10.000 euro, për një paditës/të paditur është 135.20 euro, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 103 të LPDTS-së, lidhur me nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:134334, 29.01.2024

G j y q t a r i,

Baki Shigjeqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.